REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr.4738/ Prot.
/4

Pogradec më 18 /11/2024

PROJEKT- VENDIM

Nr: _____, datë ____/11/2024

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE DHE PLANIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE TË KËSHILLIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2025**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, Për vetëqeverisjen vendore" neni 54, pika a dhe neneve 28 pika 3, 56, pika 1, gërma g, 134, pika 2 dhe 152, pika 2 e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Pogradec me propozim të Kryetarit dhe Sekretarit të Këshillit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Planin e Aktiviteteve dhe Planin e Konsultimeve Publike të Këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2025 bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetarja e Këshillit dhe Sekretariati i Këshillit.
3. Plani i aktiviteteve i nënshtrohet ndryshimeve të herëpasherëshme dhe përditësohet nga Sekretariati i Këshillit pa pasur nevoje për miratim.
4. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI E KËSHILLIT**

**Manjola KAMOLLI**

Bulevardi "Rreshit Çollaku, Igj: nr. 2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, e-mail: bashkiapogradec@gmail.com

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI I BASHKISË**

# DOKUMENTI I DEKLARIMIT TË POLITIKAVE ORJENTUESE TË KËSHILLIT TË BASHKISË POGRADEC PËR PERIUDHËN VITIN 2024

Ky dokument përcakton prioritetet kryesore të politikave të punës së Këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2025. Me anën e këtij dokumenti anëtarët e Këshillit të Bashkisë bien dakort të punojnë së bashku për të realizuar objektivat e përcaktuara më poshtë duke orjentuar punën e tyre në aktivitetet në funskion të këtyre politikave dhe duke I detajuar ato në plan aktivitetesh.

Ky dokument bazohet në të drejtat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Bashksië të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015"Për vetëqeverisjen vendore".

Me synimin për të planifikuar ushtrimin sa më mirë të këtyre koopetencave dhe me qëllimin e përfaqësimit të interesave të komunitetit dhe grupeve të interest që përfaqësojnë anëtarët e këtij Këshilli:

## VENDOSËM

- Të punojmë së bashku për fuqizimin e rolit të Këshillit të Bashkisë në vendimarrje përfaqësim dhe monitorim/mbikqyrje duke bashkëqeverisur së bashku me komunitetin.
- Të realizojmë qeverisje së bashku me komunitetin duke ushtruar së bashku më qytetarët rolin vendimmarrës, përfaqësues dhe monitorues. Për këtë qëllim:
  - o Të sigurojmë transparencë për vendimarrjen duke përfshirë sa më shumë pjesëtarë të komunitetit në këtë proces.
  - o Të japim mundësinë cdo anëtari të komunitetit tonë që të ketë informacion mbi projekt aktet dhe aktet të cilat miratohen si dhe të ketë mundësinë të shprehë lirshëm mendimin dhe opinionin e tij për cdo çështje që shtrohet për miratim.

- o Të krijojmë mundësi ndërveprimi më anëtarët e komunitetit për të përcjellë cdo shqetësim apo ankesë, për të ndërmarrë cdo iniciativë vendimarrëse për shërbimet publike që ofron bashkia.
- o Të informohemi nga administrata dhe të informojmë komunitetin tonë mbi cdo investim, apo plan strategjik zhvillimor duke kërkuar mendime dhe sygjerime nga komuniteti.
- o Të informojë qytetarët jo vetëm mbi cështjet e detyrueshme për konsultim të cituara shprehimisht nga ligji nr. 139/2015"Për vetëqeverisjen vendore" por edhe duke bërë transparencë për të ardhurat, shpenzimet dhe mënyrën e kryerjes së shërbimeve publike nga ana e Bashkisë.
- o Për të qënë sa më afër komunitetit dhe për të bashkëqeverisur me ta, do përdorim mekanizmat e bashkëqeversijes, transparencës në cdo akt që do ndërmarrim, duke riorganizuar, përmirësuar edhe krijuar mekanizmat e mëposhtme:
    - ▪ Përmirësuar ndërfaqen e Këshillit të Bashkisë Pogradec.
    - ▪ Publikimin e cdo projekt akti ose nevoje për vendimarrje si dhe duke nxitur reagimin qytetar me praktikat më të mira.
    - ▪ Konsideruar, shqyrtuar dhe zgjidhur me seriozitet cdo ankesë, kërkesë, nismë apo peticion qytetar e cila është brenda fushës së veprimit të pushtetit vendor.

- Për këtë qëllim angazhohemi të rritim aftësitë profesionale duke marrë pjesë në trajnime dhe zbatuar me përpikmëri detyrimet ligjore dhe rritur besimin e qytetarëve në institucionin tonë.
- Për këtë qëllim, pas diskutimit në grupet e punës dhe të interesit biem dakort të orjentojmë punën tonë sipas planit të aktiviteteve bashkangjitur këtij dokumenti.
- Janë të mirëpritura iniciativat dhe sygjerimet nga të gjithë banorët për të bërë pjesë të këtij plani aktivitetesh cdo çështje tjetër e cila vlerësohet e rëndësishme.

***Ju Faleminderit!***

- ***Ky dokument është I shoqëruar nga Plani I Aktiviteteve, Plani I Konsultimeve Publike bashkangjitur.***

Bulevardi "Rreshit Çollaku, lgj: nr. 2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, e-mail: bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI I BASHKISË

## PLAN I KONSULTIMEVE PUBLIKE TE KESHILLIT BASHKIAK

**(Viti 2025)**

*Plani I konsultimeve eshte vlerësim paraprak I nevojave për kunsultim public. Ky plan do rishikohet dhe do përditësohet nga nevojat për konsultim që do vijnë nga project vendimet të cilat do paraqiten për vendimarrje duke parë detyrimin ligjor për konsultim dhe nevojën e këshillit për të realizuar procesin e konsultimit public.*

**Muaji Janar**

1. Sondazh me qytetarët për tavanet buxhetore të vitit 2026-2028

**Muaji Shkurt**

1. Sondazh me qytetarët për tavanet buxhetore të vitit 2026-2028

**Muaji Mars**

**Muaji Prill**

1. Konsultim Publik për draftin e I të buxhetit afatmesëm 2026-2028.

**Muaji Maj**

1. Konsultim Publik për draftin e I të buxhetit afatmesëm 2026-2028.

**Muaji Qershor**

**Muaji Korrik**

**Muaji Gusht**

1.Konsultim me komunitetin për nevojat e qytetarëve.

**Muaji Shtator.**

**Muaji Tetor**

1.Konsultime Publike per Paketen Fiskale dhe Buxhetin 2025

**Muaji Nëntor**

Konsultime Publike per Paketen Fiskale dhe Buxhetin 2025

**Muaji Dhjetor**

1. Realizimi I një konsultimi mbi vlerësimin e figurave të bashkisë. Procedurat, kriteret.

- *Ky plan i konsultimeve mund të ndryshojë sipas nevojave të paparashikueshme në momentin e hartimit të tij.*
- *Cdo ndryshim im tij nëpërmjet vendimarrjes, apo zhvillimit të konsultimit të paparashikuar do të pasqyrohet në këtë plan.*
- *Takimet dhe konsultimet me komunitetin mund të realizohen edhe nëpërmjet rrjeteve sociale duke lënë gjithnjë të hapur mundësinë e dhënies së mendimeve dhe vërejtjeve nga të interesuarit. Cdo sygjerim, koment, apo mendim protokollohet nga Sekretari i këshillit dhe prezantohet në Komisionin përkatës apo mbledhjen e Këshillit.*

**Keshilli Bashkiak Pogradec**

*Hartimi I planit të aktiviteteve synon përcaktimin e një kornize orientuese mbi punën dhe aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Pogradec duke pasur parasysh fuqizimin , ruajtjen e autonomisë së Këshillit , si dhe siguron ushtrimin e funksionit legjislativ si organ përfaqësues, vendimarrës, mbikëqyrës e monitorues.* ***Ky Plan aktivitetesh është orjentues dhe mundet të ndryshojë për cdo emergjencë, apo situatë të paparashikueshme në momentin e hartimit të tij.***

| Permbledhese | PLANI I PUNES | PLANI I VENDIM-MARRJES (shqyrtim+miratim) |
|---|---|---|
| | Pershkrimi i Aktivitetit | Pershkrimi i aktiviteteve |
| | **Mbledhje Keshilli** (gjithesj 16=12+4, nje mbledhje cdo muaj+ 4 muaj ku mbahen 2 mbledhje ne muaj) | Miratim i normave, standarteve dhe rregullores se sherbimeve publike opsionale |
| | **Mbledhje Komisionit te Perhershem e Mikse** (mesatarish 5 mbledhje komisionesh ne muaj) | Miratim i normave, standarteve dhe rregullores se sherbimeve administrative (taksave, ankesave etj) |
| | **Takime me komunitetin, konsultime**: buxhet (cdo NjA+ komuniteti biznesit+OJF), pakete fiskale (cdo NjA+ komuniteti biznesit+OJF);; shitje, blerje e dhenje me qera (1 ne qytet dhe ne 1 ne NjA ku ndodhet prona) rast pas rasti; norma e standarte e rregullore te sherbimeve dhe fuksioneve te tjera ligjore (sipas grupit te interesit dhe shtrirjes se sherbimit)rast pas rasti, strategjite (strategjia e zhvillimit 1 ne cdo NjA) rast pas rasti; planet e sherbimeve - social, Plani menaxhimit te mbetjeve (1) rast pas rasti. | Miratim i Planit te sherbimit publik (mbetjeve, ujit, rrugeve, ndricimit, pyjeve, kanaleve kulluese, tj) |
| | **Trajnime**: te Keshilltaréve ( 1 Trajnim per keshilltaret ,kryetaren e keshillit,kryesine e keshillit,komisionet e keshillit, per sekretariatin e Keshillit. 1-2 here ne vit. | Miratim i Planit zhvillimor (ekonomik, social, kultures, zhvillimit te strukturave komunitare etj) |
| | **Pjesëmarrje ne konferenca** (2) sipas rastit | Miratim i Strategjise se zhvillimit te bashkise opsionale<br>Miratim i Planit te sherbimit te qeverise (buxhet, fiskal, asete, BNj, huamarrje, qeverise elektronike, etj) |
| | **Ceremoni** dhenje titull nderi | Raport per zbatim te strategjise, planit sektorial apo horizontal (buxhetit, fiskal, PPV, mbetjeve, ujit etj) |
| | **Pritje e delegacionit** nga keshilla homologe (1) planifikohet rast pas rasti/ ne baze te kerkeses | Raport per performancen e sherbimit, ndermarrjes, institucionit, qendres, agjencise opsionale/periodike<br>Raport per performancen e qeverisjes bashkiake, ankesa e kerkesa, konsultime, transparenca etj /raporti I punes se KB |
| | **Perfaqesim institucional i Keshillit ne ngjarje**, psh festa vendore, ngjarje ku ftohet Keshilli **rast pas rasti** | Shqyrtim i projekt buxhetit (sipas etapave te miratimit te buxhetit), Shqyrtim i planit fiskal dhe zbatimit<br>Degjese publike me anetaret e keshillit apo komisionit te KB<br>Akte individuale (ndihma ekonomike, bursa etj) |
| | **Hartim/Amendim i dokumenteve planifikues te KB: buxheti vjetori, plani vjetori i vendim-marrjes, plani i komunikimit me publikun.** | Emertesa (psh, rrugesh), Tituj nderi (psh, qyetar nderi etj), Ceremoni opsionale |

| Muaji | Pershkrimi i Aktivitetit | Pershkrimi i aktiviteteve (sqarim) |
|---|---|---|
| **Janar** | Mbledhje e Keshillt **(Plenare)** | Axhenda e miratuar nga Kryesia e keshillit, Procedura sipas rregullores se Keshillit |
| | Mbledhjet e Komisioneve te Perhershem te: 1. Finances 2.Buxhetit; komisione te tjera sipas Projekt-Vendimeve te paraqitura | Raportet e komisioneve sipas temave te parashikuara ne Agenden e Janarit (nje pjese) |
| | Terheqje e mendimit qytetar per prioritetet e tavaneve pergatitore buxhetore 2026-2028 | Pergatitje e sondazhit, publikim ne faqen web te KB/faqen FB te kB |
| | Raporti Vjetor I Performancës se Keshillit Bashkiak për vitin 2024 dhe prezantimi në mediat lokale . | Permbledhje e punës që ka bërë Këshilli përgjatë një viti . |
| | Hartimi I Planit vjetor të vendimarrjes së Këshillit , Hartimi I Planit vjetor të komunikimit . | Hartim Plani |
| | Raportim nga Njësia e Integrimit Europian dhe ndihmës së huaj për projektet e fituara gjatë vitit 2024 dhe objektivat për vitin 2025 | Përmbledhje e punës që ka bërë Njësia e Integrimit përgjatë një viti |
| **Shkurt** | **Mbledhje e Keshillt (Plenare)** | Agenda e miratuar nga Kryesia e keshillit, Procedura sipas rregullores se Keshillit Miratimi i ndihmave ekonomike, suporti social 6% |
| | Mbledhjet e Komisioneve te Perhershem te: 1. Finances 2.Buxhetit; komisione te tjera sipas Projekt-Vendimeve te paraqitura | Raportet e komisioneve sipas temave te parashikuara ne Agenden e Shkurtit (nje pjese) |
| | Raportim nga Drejtoria e Burimeve Njesëzore . | Raportim nga Drejtoria e Burimeve Njesëzore për Këshillin Bashkiak |
| | Analize dhe permbledhje e mendimit qytetar per prioritetet e tavaneve pergatitore buxhetore 2026-2028 | |
| | Raporte te monitorimit te buxhetit:raporti I 4 mujorit te trete . | Raport I pergatitur nga drejtoria e financave |
| | Trajnim per komisionet dhe per sekretarin e KB nga BtF, sipas kalendarit qe do te njoftohet. | |
| | | |
| **Mars** | Mbledhje e Keshillt **(Plenare)** | Agenda e miratuar nga Kryesia e keshillit, Pricedura sipas rregullores se Keshillit Miratimi i ndihmave ekonomike, suporti social 6% |
| | Mbledhjet e Komisioneve te Perhershem te: 1. Finances 2.Buxhetit; komisione te tjera sipas Projekt-Vendimeve te paraqitura | Raportet e komisioneve sipas temave te parashikuara ne Agenden e Mars (nje pjese) |

| | | |
|---|---|---|
| | Raportim nga Drejtoria e Shërbimeve të pyjeve dhe kullotave ne lidhje me masat e marra per mbrojtjen e pyjeve nga prerja pa kriter. | |
| | Raporti mbi realizimin e te ardhurave per 8 mujorin e pare dhe zbatimin e buxhetit. | Monitorimi i realizmit te 8-mujorit te te ardhurave |
| **Nentor** | Mbledhje e Keshillt **(Plenare)** | Agenda e miratuar nga Kryesia e keshillit, Pricedura sipas rregullores se Keshillit Miratimi i ndihmave ekonomike, 6% |
| | Mbledhjet e Komisioneve te Perhershem te: 1. Finances 2.Buxhetit; komisione te tjera sipas Projekt-Vendimeve te paraqitura | Raportet e komisioneve sipas Rregullores se Organizimit dhe Funksionimit. |
| | Miratimi I dokumentit te PBA 2026-2028, | |
| | Miratim I planit te aktiviteteve, buxhetit dhe planit te konsultimeve te KB per 2026 | |
| | Pjesemarrje ne konferenca e aktivitete të ngjashme (Festat e Nentorit, etj) | |
| **Dhjetor** | Mbledhje e Keshillt **(Plenare)** | Agenda e miratuar nga Kryesia e keshillit, Pricedura sipas rregullores se Keshillit Miratimi i ndihmave ekonomike; 6% |
| | Mbledhjet e Komisioneve te Perhershem te: 1. Finances 2.Buxhetit; komisione te tjera sipas Projekt-Vendimeve te paraqitura | Miratimi i dokumentit të PBA-së përfundimtare dhe buxhetit vjetor |
| | Miratimi I Paketes fiskale dhe buxhetit 2026 | |
| | Emision ose interviste ne median vendore dhe online | Realizimi I nje interviste. (opsionale) |
| | **Pjesemarrja ne mbledhjet e Keshillit te Qarkut sipas axhendes se institucionit** | **Pjesemarrje ne mbledhje** |

**Ky Plan I aktiviteteve mund të ndryshojë sipas nevojave të paparashikueshme në momentin e hartimit të tij.**

Cdo ndryshim I tij nëpërmjet vendimarrjes ,apo zhvillimit të aktivitetit të paparashikuar do të pasqyrohet në këtë plan dhe do të jetë objekt I monitorimit të performancës së Këshillit dhe do raportohet si I tillë në fund të vitit.

Konceptoi:Sekretare e Keshillit
Jona Bojko
Miratoi:Kryetare e Keshillit
Manjola Kamolli